



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË

Tiranë, më 10.12.2025

NJOFTIM

PËR FILLIMIN E PROÇEDURËS SË KONKURIMIT
PËR
EMERIMIN NË POZICIONIN E PUNËS NJË VEND
PUNONJËS SHERBIMI

Bazuar në Ligjin Nr 97/2016 “ Për Organizimin dhe funksionimi e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë , si dhe mbi bazën e “ Strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, me qëllim plotësimin e vendit vakant në zbatim të strukturës së Institucionit, në përmbushje të organikës Nr. 17 datë 29.01.2025 të Prokurorit të Përgjithshëm për Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vitin 2025 .

1. Kërkohet të punësohet 1(një) punonjës me emertese punonjës sherbimi , në Prokurorinë Pranë Gjykatës së shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me adrese ,Rr. Haxhi.H. Dalliu Nr 97 Tiranë..

N J O F T O N

1.Fillimin e Proçedurës së konkurimit të hapur të kandidateve për një pozicion me emertese punonjës sherbimi, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë .

2. Referuar neneve 74,75,76 të Ligjit nr 97/2016 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë “,kandidatet e

interesuar për konkurim, përveç kushteve të përgjithshme për tu pranuar në punë, duhet të plotesojnë dhe kriteret të veçanta.

1.Kandidatët për një pozicion të lire të punës “punonjës shërbimi” duhet të paraqesin kërkesën së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm që kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur
- d) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë nën hetim;
- f) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo administrata shtetërore që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- g) të ketë përfunduar arsimin e mesëm apo të lartë

Kushtet e veçanta :

- a) Kërkesë për punësim,
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së mesme ose të lartë , liste notash e fotokopjuar dhe e noterizuar
- e) Dëshmi kualifikimi (nese ka)
- f) Vërtetim përmbarimi gjyqësor
- g) Vërtetim për gjendjen gjyqësore (Dëshmi penaliteti).
- h) Vërtetim nga Gjykata .
- i) Vërtetim nga Prokuroria
- j) Fotokopje të librezës së punës
- k) Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- l) Vërtetim i njësisë administrative
- m) Vërtetim mjekësor për gjendjen shëndetësore i afte për punë
- n) Vërtetim se ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore në marredhënie punedhe /ose ndonjë masë tjetër disiplinore

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kandidatit, të paraqitet nga dt.10.12.2025 ora 8.00 deri në datë 24.12.2025 ora 16.00, në K/sekretarinë e

Prokurorisë Pranë gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë , Rr “ Haxhi.H. Dalliu “ Nr 97 Tiranë .

Konkurimi për vendin e punës në pozicionin “ Punonjës Sherbimi “ do të zhvillohet në dy faza :

Faza e parë : Verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatet , e cila realizohet nga Kancelari i kësaj Prokurorie, me qëllim vlerësimin e dokumentacionit nëse janë plotësuar kriteret e shpallura në njoftim .

Kandidatët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë : Intervista .

Vlerësimi i kandidatëve nga komisioni do të bëhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat si dhe rezultati i intervistës.

Në përfundim të vlerësimit të kandidateve , Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë do të njoftojë kandidatët individualisht për rezultatin.

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLË SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË**